



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 953/ 12 prot.

Datë 06/05/2025

V E N D I M

Nr. 626/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06/05/2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 561/2025, datë 24.04.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-37939-02-12-2025, me objekt: “BLERJE HIPOKLORIT NATRIUMI + REAGENTE KLORË”, me fond limit 5.379.200 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 25.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan Sh.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I, dhe me adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan Sh.A. Adresa: Lagjja: “Brigada XVII Sulmuese”, Rruga: “Petraq Popa” Elbasan.

Persona të interesuar: Operatori ekonomik “2 AT” SHPK, me Nipt K14019001H me adresë: Z. Kadastrale 1101, Nr. pasurie 262/82 Dishnicë, Korçë.

Operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK, me Nipt K22218003V me adresë: Autostrada Tiranë - Durrës, Km. 10, Rruga dytësore, Vorë, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I****Rrethanat e çështjes**

I.1. Në datë 24.04.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 561/2025, ku vendosi:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” ShPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-37939-02-12-2025, me objekt: “BLERJE HIPOKLORIT NATRIUMI + REAGENTE KLORI”, me fond limit 5.379.200 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 25.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan Sh.A.
2. Të konstatoj absolutisht të pavlefshëm pikën 1 e dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës referuar shkresës nr. 287/15, datë 17.04.2025 “Vendim” për pranimin pjesërisht të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” ShPK, të marrë në kundërshtim me hapat proceduralë që parashikon ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” ShPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 771/1 prot., datë 29.04.2025, protokolluar me tonën nr. 953/9 prot, datë 02.05.2025, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan Sh.A lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 561/2025, datë 24.04.2025, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke e shpallur absolutisht të pavlefshëm pikën 1 të dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës referuar shkresës nr. 287/15, datë 17.04.2025 “Vendim” për pranimin pjesërisht të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” ShPK.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 771/1 prot., datë 29.04.2025, protokolluar me tonën nr. 953/9 prot, datë 02.05.2025, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan Sh.A lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 561/2025, datë 24.04.2025, njofton se ka zbatuar vendimin e sipërpërmendur, duke e shpallur absolutisht të pavlefshëm pikën 1 të dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës referuar shkresës nr. 287/15, datë 17.04.2025 “Vendim” për pranimin pjesërisht të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” ShPK.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe verifikimeve të bëra në systemin e prokurimeve elektronike (SPE) konstatohet se autoriteti kontraktor ka shpallur absolutisht të pavlefshëm pikën 1 të dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës referuar shkresës nr. 287/15, datë 17.04.2025 “Vendim” për pranimin pjesërisht të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” ShPK, sipas përcaktimeve të Vendimit K.P.P Nr. 487/2025, datë 11.04.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*E hapur*”, me Nr. *REF-37939-02-12-2025*, me objekt: “*BLERJE HIPOKLORIT NATRIUMI + REAGENTE KLOR*”, me fond limit 5.379.200 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 25.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan Sh.A.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

